




REPublika e Kosoves/REPublika Kosova/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-2743/13
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 10-09-2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.09.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-455/13,për Zyrtarin e Lartë, z.Valon Grabovci, Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit ne Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi qe ka ber shuarjen vullnetare te biznesit privat qe e kishte te regjistruar .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 te ligjit Nr.04/L-051,Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës se marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK–03-455/13, që për trajtim ka pasur Zyrtarin i Lartë, z. Valon Grabovci, Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit ne Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Zyrtar Kryesor Financiar ne, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, është duke ushtruar edhe një funksion në biznesin private “Pro Trade Group sh.p.k”, e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 05.03.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Valon Grabovci, Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit ne Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar qe ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm te interesit.

Zyrtarët e agjencisë e kanë njoftuar me faktet dhe situatën , lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, z. Grabovci është pajtuar për situatën ne të cilën ndodhet, mirë po është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi qe nuk e ka informuar askush qe nga momenti i zgjedhjes si zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit ne Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës , dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë qe mund të shkaktoj konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, dhe është arsyetuar se biznesi ne fjalë nuk është funksional por është vetëm i regjistruar dhe do te filloj menjëherë procedurat për shuarjen, mbylljen e biznesit.

Zyrtari i lartë, z.Valon Grabovci, Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit ne Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, ka sjellë dëshminë se ka filluar procedurat për shuarjen e biznesit ne fjale.

Agjencia kundër Korrupsionit ka përcjellë ecurinë deri sa është njoftuar me dokumentin final te lëshuar nga ARBK-ja ku thuhet se është ber asgjësimi, shuarja vullnetare e biznesit me emër “Pro Trade Group sh.p.k” .

Andaj konsiderojmë se zyrtari i lartë z. Valon Grabovci, Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës pasi ka ber shuarjen, mbylljen vullnetare te biznesit private “Pro Trade Group sh.p.k”, ka shmangur gjendjen e mundshme te Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

